ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-3056-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **112 Ndertimi i rrugeve në fshatin Mramor**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KONZERCIUMI. NNT ,, BURIMI,, BI Agim Morina, & NPSH WORLD MEDIUM ,
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Imer Krasniqi pnr, Malisheve.
(Adresa)

Malisheve ***24000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

+383 44 136-530 , 044749-220
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Jemin Morina.
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nntburimi@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.07.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Ndërmarrja Ndërtimore Transportuese AGIM MORINA B.I BURIMI MALISHEVE

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e publikimit ne e-prokurim: 29.03.2024
Data e hapjes se tenderi: 24.04.2024
Data per njoftimin e AK: 07.06.2024
Data e Pezullimit: 12.06.2024
Data e vendimit të AK: 18.06.2024
Data e njoftimit të AK: 08.07.2024
Data e njoftimit (refuzimi i kërkesës për rishqyrtim): 15.07.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
1. Shkelja e nenit 1-Qellimi **2. Shkelja e nenit 6-Ekonomiciteti dhe efikasiteti** **3.Shkelja e nenit 7-Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi** **4. Shkelja e nenit 51-Njoftim i kritereve te pergjedhura** **5. Shkelja e nenit 56-Dispozitat e pergjithma mbi perzgjedhje e pjesmarresve dhe dhenie e kontrates** **6.Shkelja e nenit 59-Ekzaminimi,vleresimi dhe krahasimi i tendereve** **7. Shkelja e nenit 60-Kriteret per dhenie te kontrates** **8. Shkelja e nenit 66-Pershtateshmeria profesionale** **9.Shkelja e nenit 72-Dokumentacioni edhe informacioni shtese**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Parahyrje:

Se pari me rastin e njoftimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK nuk ka shtjelluar as edhe një pretendim tonin për OE të rekomanduar për kontratë dhe kjo është në kundershtim me LPP-në.
Është e habitshme sesi AK nuk e ka trajtuar asnjë nga pretendimet tona për GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM dhe kjo përpos që ngjall shum dyshime, është edhe e pa pranueshme nga ne si ofertues dhe ankues në këtë rast.

Grupi i operatoreve ekonomik *: KONZERCIUMI. NNT ,, BURIMI,, BI Agim Morina, & NPSH WORLD MEDIUM.*

Ne GOE N.N.T BURIMI/Agim Morina B.I & NPSH WORLD MEDIUM, jemi eleminuar dhe diskriminuar deri në atë fort sa AK ka bërë trajtim jo të barabart ndaj nesh ne krahasim me GOE të rekomanduar për kontratë. Ne vazhdim do e sqarojm dhe argumentojm ofertën e dorzuar pran AK sepse arsyet e eleminimit sipas njoftimit të datës: 08.07.2024 nuk qendrojn.

AK arsyen e parë të eleminimit e ka cekur në njoftimin për vendimin e AK ku ne bazë të njoftimit ne nuk e kemi plotesuar ANEKSIN 7, konkretisht listen e projekteve të realizuara.
SQARIM: Në ofertën qe kemi dorzuar, konkretisht nr. rendor 7. Kontratat Burimi, kemi paraqitur sakt dhe qart një listë të kontratave të cilat janë realizuar duke e përmbushur edhe kërkesën e dosjes se tenderit.
Plotesimi i ANEKSIT 7 ëështë i barazvlefshem me Listen e Kontratave të realizuara nga kompania N.N.NT BURIMI/Agim Morina B.I, e cila është e nënshkruar dhe vulosur (origjinal)
Pra mos plotesimi i ANEKSIT 7 nuk e ndryshon rrjedhen e ofertës në përmbushjen e kërkesave të dosjes se tenderit meqenese te gjitha të dhënat në listën e kontratave janë të mjaftueshme për verifikim dhe qartesim te kontratave nga ana e AK. Aq me shum kur kjo list e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur në origjinal) nuk paraqet ndonje dem material për AK.
Mendojm se AK ka hapsir të mjaftueshme qe listen e kontratave të prezantuara nga ana jonë ta merr si të mirëqenë dhe si plotesim i kushteve të dosjen e tenderit. Rrjedhimisht ne nuk duhej eleminuar në këtë pik po duhej vazhduar si të përgjegjshem.
Pra argumenti jonë në këtë pikë mendojm se është i qart dhe sqarues për AK.

Tek pika 4. Udhehqesi i punimeve
Meqenese ne kemi prezantuar Ing. e ndertimtarisë/Konstruktiv, AK ka mundur qe të kërkon informata sqaruese lidhur me vendimin për udheqes të punimeve.

Sa i përket kërkesës 7. Të dosjes se tenderit, konkretisht Një (1) Ripper (Gremq), sqarojm se kjo paisje nuk ka nevoj te paraqitet ne listen e mjeteve sepse është pjesë përcjellese e eskavatorit, por si deshmi e kemi paraqitur faturën me nr. 8, Datë: 07.05.2011. Emertimi lugë (kova) vjen sipas regjistrimit ne doganë dhe nuk percaktohet nga ne.
Pra paisja e cila kërkohet ne dosjen e tenderit është pjes e paisjeve tona dhe si te till ju sugjerojm edhe ta bëni një vizitë tek ne dhe të vertetohet kjo paisje.
Gjithashtu sa i përket Një (1) Dozer (Buldozher) pesha 18-20 ton kemi paraqitur një faturë me nr. 002/20 të datës 10.12.2020
Ndersa Një (1) Cilinder për asfalt gome hekur e kemi paraqitur si foto me të dhëna.

GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM

Sa i përket GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM i rekomanduar për kontrat nuk i ploteson kërkesat e DT dhe NJK për këto aryse:

Tek Pika 2. Certifikata për regjistrim në TVSh
Lidhur me Kete Pike OE-s , N.N.SH VICTORY COM i mungon Qertifikata e TVSH ,si eshte kerkuar ne DT.
Pra Pika 2 nuk i permbush kerkesat e DT.

Tek pika 3.Menaxher i projektit (kontratës) Vërejtje Menaxheri duhet të jetë me profesion nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë
3. •Diplomë universitare e programit Master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në Kosovë) • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat. • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 12 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; • Certifikat për Siguri dhe Shëndeti ne Pune
Lidhur me këtë pik, GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM në ofertën e tyre kan prezantuar Ing. Ndërtimtarisë Beqë Hadërgjonaj duke mos prezantuar fare përvojën e punës përmes kontratave me punëdhenësin qe rrjedhimisht GOE të rekomanduar për kontrat nuk i ploteson kërkesat e dosjes se tenderit.
Pra pika 3. Nuk i përmbush kërkesat e DT.

Tek pika 4.Udhëheqës i punishtes (kontratës) Vërejtje Udhëheqësi duhet të jetë me profesion nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë
4.•Diplomë universitare e programit min. Bachelor • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Një (1) kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat. • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min.3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; • Certifikat për Siguri dhe Shendeti ne Pune
udheheqesi i punishtës Erblin Sopa-Ing i Ndertimtarisë/Konstruktiv, në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM e cila është prezantuar, nuk është e nënshkruar fare CV-ja e ing. ashtu siq është kërkuar ne Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, pra si e till duhet eleminuar nga ky aktivitet i prokurimit meqenese nuk i përmbushë kërkesat.
Gjithashtu krahasuar CV-në me REFERENCA ka mospërputhje të medha sepse ne CV-në e Ing. Erblin Sopa figurojn vetëm 8 muaj përvoj pune ndersa ne Referenca nuk figurojn vitet e punës.

Në bazë të UDHEZUES nr. 001/2023 PËR PROKURIM PUBLIK:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
CV-ja e dorzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Pika 4. Nuk i përmbush kërkesat e DT.

Tek pika 5.Një (1) Inxhinier i infrastrukturës rrugore apo të komunikacionit.

5.•Diplomë universitare e programit Master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në Kosovë) • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Një (1) kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat. • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 5 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës;

GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM në ofertën e tyre ka paraqitur Ing. I Komunikacionit i cili nuk i përmbushë kërkesat e dosjes se tenderit mbi përvojën e punës pasiqe në CV-në e prezantuar figurojn gjithsejt **4 vite e 1(një) muaj përvoj pune (Gusht 2019 – Gusht 2023, Kompania e Sigurimeve ''SIGKOS'')** ndersa ka diplomuar në vitin 2019-Studimet i mbaroj me 27 dhjetor 2018 ndersa diplomoj me 7 shkurt 2019. Pra nuk i përmbush kërkesën e dosjes se tenderit.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
CV-ja e dorzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Mungon përvoja e punës përmes kontratave me punëdhenesin.
Mungojn referencat dhe 1(një) kontratë për realizimin e punëve të ngjajshme
Pika 5. Nuk i përmbush kërkesat e DT.

Tek pika 6.Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Drejtimi Gjeodezi.
6.•Diplomë universitare e programit min. Bachelor •Kopja e licencës valide. • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Një (1) kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat. • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; • Certifikat për Siguri dhe Shëndeti ne Pune

GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM ka prezantuar 1 Ing të Gjeodezis, Florent Retkoceri të cilit i mungon Çertikikata për Siguri dhe Shendet në punë dhe i cili nuk ka prezantuar përvojën e punës përmes kontratave me punëdhenesin.
Po ashtu Gjeodeti tjetër Haki Mehmeti nuk ka prezantuar përvojën e punës përmes kontratave me punëdhenesin.
Pika 6. Nuk i përmbush kërkesat e DT.

Tek pika 7.Lista e pajisjeve profesional të OE. • Katër (4) Kamionë për transport • Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me goma 18-20ton • Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me zinxhir me pesh 18-20 ton • Një (1)Mini Ekskavator me cekan me pesh 1-1.5ton • Një (1) Cilinder për vibrim 19 -21 ton • Një (1) Dozer (Bulduzher 18-20 ton • Një (1) Grejder • Një (1) Finisher • Një (1) Cilinder per asfalt gome-heker pesha 2-2.5 ton • Një (1) Cilinder per asfalt heker heker pesha mbi 8 ton • Një (1) Ripper (Gremq) per eskavator me pesh 18-20ton • Një (1) Ngarkues me pesh 5-6ton

7.Lista e pajisjeve profesional të OE. Aneksi 8 i DT. Duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për pajisjet OE. duhet të prezantoj njërën nga këto dokumente Për automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, te gjitha ato mjete qe paraqiten me faturë te blerjes duhet te kenë te bashkangjitur edhe dud-in doganor. Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE. duhet te ofroj marrëveshjen

për marrjen me qira te pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me larte. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët po ashtu marrëveshja duhet te jete e noterizuar. Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionat, regj.i targave, mekanizimi).

Sa i përket marrëveshjes se lidhur në mes të MARISA SH.P.K dhe ARJAK SH.P.K për Grejder, Finisher dhe Cilinder Asfalti, nuk është e plotesuar si duhet për shkak se Investitori apo AK është Kuvendi i Komunes se Prishtinës e jo ashtu siç është paraqitur në marrëveshje si Investitori - AK: Komuna e Gjakovës. Pra ka kundershti brenda marrëveshjes dhe si e till nuk është në harmoni me AP.

Pastaj qfar është shum e rendesishme qe GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM te rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur fare List të Paisjeve të nenshkruar dhe vulosur ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
Pra është i papërgjegjshem.

Brenda pikës 7. Është kërkuar Një (1) Eskavator për gërmim dhe ngarkim me goma 18-20 ton. **Në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM nuk është paraqitur fare një eskavator i till.**
Pra është i papërgjegjshem.

Tek pika 7. është kërkuar: Një (1) Dozer (Bulduzher) 18-20ton. Në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM nuk është paraqitur fare një Dozer (Bulduzher) te till. Ne ofert se bashku me DUD ka paraqitur një CATERPILLAR Tipi M315 i cili ka pesh 17.500 kg (17.5 ton) e i cili nuk e arrin peshen e kerkuar ne dosjen e tenderit (18-20ton) dhe i cili është paraqitur vetem si Eskavator e jo Bulduzher ashtu siç është kërkuar.
Pra është i papërgjegjshem.

Tek pika 7. është kërkuar: Një (1) Cilinder për asfalt gome-hekur pesha 2-2.5 ton. Në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM nuk është paraqitur si cilinder per asfalt gome hekur po vetem si Rul pë shtrimin e rrugve-Vibrator.
Kjo gjithashtu nuk mund te merret si e pranueshme sepse ka dallim mes ngjeshesit të rrugëve dhe ati për asfalt.

Tek pika 7. është kërkuar: Një (1) Ripper (Gremq) për skavator me pesh 18-20 ton. Në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM figuron një **Kontratë Shit Blerje** e cila ta krijon përshtypjen qe është kontrat fiktive për shkak se nuk e përmban asnjë element të kontratës se rregullt. Por prap se pram ne pikën 7. te deshmia e dokumenteve të cilat nuk regjistrohen është kërkuar DUD apo faturë e blerjes, qe në këtë rast nuk janë paraqitur as DUD e as faturë blerje por vetem një kontrat qe duket shum e dyshimt.
Pra është i papërgjegjshem.

Tek pika 7. është kërkuar: Një (1) Ngarkues me pesh 5-6 ton. Në ofertën e GOE MARISA SH.P.K & N.SH.T VIKTORY COM nuk është paraqitur fare një ngarkues me pesh 5-6 ton. **Pra është i papërgjegjshem.**

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet tona kërkojm nga: OSHP qe të:

APROVOHET si e bazuar ankesa jonë,
ANULOHET B58 Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënjen e kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*